



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARGALINA Y. DAUTI
ADRESA Rruga "Muhamet Gjollësia,
Pall. Moskat, shk 3, ap 14"
TEL: 692204572



KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT

Nr. repertori: 3344

Nr. koleksioni: 1744

Tirane më 27/06/2024

Margalina
Dauti

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten
:Margalina Dauti
Data: 2024.06.27
11:47:08+02:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024050360205844859

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2024050360205844859

AKT THEMELIMI
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"E&E Holding " SH.P.K

Sot, më datë 28/06/2024, para meje Notere MARGALINA Y. DAUTI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga "Muhamet Gjollësia, Pall. Moskat, shk 3, ap 14", u paraqit personalisht:

ORTAKU:

Erind Ruka, atësia Servet, amësia Marjeta, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Selite, Shtepi Private; Nd. 009; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 08/07/1985, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 028107255 dhe nr. personal I50708060B, .

Baza Ligjore: Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar Neni 62, pika 1, gërma "I" të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*"

Rrethanat për hartimin e aktit noterial:

Personi me identitetin e mësipërm shprehu vullnetin e tij të lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të krijohet dhe veprojë sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, si dhe do të referohet për mbarëvajtjen e saj në Aktin e Themelimit të krijuar nëpërmjet këtij akti.

I.

Krijimi

I.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin ""E&E Holding " SH.P.K" sh.p.k (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), themelohet në bazë të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

II.

Objekti

II.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë konsiston ne:

- Investimi ne instrument financiar (te cilet perfshijne pa kufizime titujt e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat ne fonde investimesh etj), investimi ne pasuri te paluajtshme dhe ne asete (te prekshme apo te paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i sherbimeve te konsulences per shoqerite e kontrolluara prej saj dhe/ose te trete (te cilet perfshijne pa kufizime konsulencen e natyres financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj.) ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, Gjithashtu, shoqeria mund te kryej cdo veprim, operacion apo transakcion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundershtrim dhe mos alterojne objektin paresor te veprimtarise se shoqerise.
- Shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet tregtare, industriale, te luajtshme, te paluajtshme dhe te kryeje çfaredo lloj aktiviteti tjeter te lejuar qe konsiderohet i nevojshem per realizimin e objektit te aktivitetit te shoqerise.
- Gjithashtu shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri dhe /ose kooperativa, ndermarrje te çdo natyre qe kane objekt te njejte apo qe lidhet me objektin e veprimtarise se shoqerise.
- Te zhvilloje cdo veprimtari dhe aktivitet tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar.



II.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.

II.3 Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomik.



III.

Zyra qendrore

III.1 Zyra qendrore e Shoqërisë është në adresën: Rruga Fran Bardhi 11 Tiranë.

III. Shoqëria mund të hapë zyra dhe/ose të kryejë aktivitet në vende të tjera si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të organit kompetent ose vendimmarrës.

IV.

Kohëzgjatja

IV.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

V.

Kapitali Themeltar dhe Ortakët e Shoqërisë

V.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100'000 Lekë (njëqind mijë Lekë), i perbere nga 1 (nje) kuote, e zotëruar nga një ortak .

V.2 I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar në para nga ortaku i Shoqërisë.

V.3 Pjesët e kapitalit janë lirish të transferueshme midis ortakëve në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar.

V.4 Përgjegjësia e ortakëve për mbulimin personalisht të humbjeve të Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tyre të nënshkruar në kapitalin e Shoqërisë.

V.5 Përqindja e pjesëmarrjes e ortakut në kapitalin e Shoqërisë është: zotërues i 100 % të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë të kapitalit të barabartë me 100'000 leke (njëqind mijë leke);

V.6 Ortaku ka të drejtë të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tij në kapitalin themeltar, domethene fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

V.7 Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë; Kapitali i shoqërisë do të hidhet në Bankë pasi të dalë NIPT i shoqërisë .

V.8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.



A2024050360205844859

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

VI.

Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

VII.

Administrimi

VII.1 Shoqëria administrohet nga një, dy ose më shumë administratorë, persona fizikë të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

VII.2 Veprimet e administrimit të Shoqërisë në rast të dy administratorëve do të konsiderohen të vlefshme nëse janë ndërmarrë dhe nënshkruar nga të paktën njëri prej tyre dhe në rast të dy ose më shumë administratorëve veprimet konsiderohen të vlefshme nëse nënshkruhen të paktën nga 2 prej administratorëve të Shoqërisë.

VII.3 Administratori emërohet për një periudhë 5 vjecare dhe mund të rrimërohet, me perjashtim të rasteve të doreheqjes ose shkarkimit të parakohshëm

VII.4 Administratori i parë i Shoqërisë emërohet: Erind Ruka, i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e perfaqësimit të shoqërisë me të tretet në gjithë veprimtarinë e saj.

VII.5 Administratori shkarkohet nga detyra në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

VII.6 Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me perjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh.

VII.7 Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tremeve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.



VIII.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakut:

Ortaku gezon keto te drejta kryesore:

- Administrimin e veprimtarise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasio te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja pergjithshme e Asamblese dhe organet e tjera te shoqerise.
- Te heqe dore nga shoqeria (heqja dore nga shoqeria nuk i liron ortaket nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise).
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesit te tij ose vete.
- Te emeruje dhe te shkarkoj perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuiditoret.

Ortaku ka keto detyrime kryesore:

- Te depozitoj kuoten e tij dhe kuoten suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata.
- T'i japi shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryejë detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Ka detyrimin qe nese heq dore nga shoqeria ti njoftoj vendimin e tij asamblese 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes sipas nenit .
- Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryejë sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

IX.

Viti ushtrimor

- IX.1 Viti ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përrjashtimisht, viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregëtar dhe përfundon më 31 Dhjetor të vitit në vazhdim.

X.

Mbyllja e Shoqerise:

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga ortaku kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise (kontrata). Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.



Në këtë rast Asambleja e përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

XI.

Kur shoqëria likuidohet:

Asambleja e ortakut emeron likuiditorin, dhe shoqëria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likuidimit.

Komisioni i Likuidimit perbehet nga nje ose tre anetare.

Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakut.

Likuidimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.


Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujditoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe, secila njëlloj e vlefshme. Nënshkruar nga Ortaku Themelues sot më datë _____.

ORTAKU THEMELUES

ERIND RUKA


(emer, mbiemer, nenshkrim)

Në zbatim të gërmës "P" të pikës 1 të nenit 62 të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", ku parashikohet: *Kompetencat e noterit/es: l) përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërive tregtare*, unë noterja marr pjesë gjatë hartimit të Aktit të Themelimit të shoqërisë.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "ll", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti noterial, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
MARGALINA DAUTI

